



## POSTARCH

Emri i Projektit Park Piazza  
Project Name

Tipologjia Shërbime  
Typology Commerci

Viti i realizimit 2022  
Year of realisation


Vendi Podujevë - Kosovë  
Location Podujeva - Kosova

Autor|ët Fatlum Haliti, Menor Pajaziti  
Author|s

Bashkëpunëtorët Fjolla Januzi, Shpend Azizi, Melisa Sylja,  
Collaborators Aida Bllacaku, Florida Jakupi, Driton Ibrahim  
Solos Studio, Kerasan, Dekorativ

Fotografia XX  
Photography





"Park Piazza" ka arritur që me shumë sukses të ruajë dhe të vlerësojë trashëgiminë arkitektonike të zonës, ndërkohë që e ka përdorur atë në mënyrë që të krijojë një vend të përshtatshëm dhe tërheqës për përdoruesit. Rivitalizimi dhe përshtatja e objekteve ekzistuese për funksione të reja, që i shërbejnë qytetit, e bën këtë projekt të imponohet me gjithë madhësinë e tij. Ky është një shembull i suksesit të një projekti që ka përmbushur synimet e tij dhe ka sjellë vlera të prekshme për komunitetin.

*"Park Piazza" has managed to successfully preserve and appreciate the architectural heritage of the area, while using it to create a convenient and attractive place for users. The revitalization and adaptation of existing buildings to new functions that serve the city makes this project stand out magnificently. This is an example of the success of a project that has met its goals and brought tangible value to the community*

Transformimi i lokacionit të "Park Piazza" në një vend me vlera urbane dhe arkitektonike, ka qenë qëllimi i këtij projekti të rëndësishëm, që ka ndryshuar ndjeshëm peizazhin urban të qytetit të Podujevës. Ky projekt ka nisur në një hapësirë industriale të braktisur, me idenë për ta kthyer në një qendër tërheqëse për komunitetin dhe vizitorët. Një ndër karakteristikat kryesore të këtij projekti është ruajtja e vlerave arkitektonike të konstruksioneve ekzistuese, duke i ndryshuar funksionet e tyre për të plotësuar nevojat e reja urbane.

*The transformation of the "Park Piazza" location into a place with urban and architectural values is an important project that has significantly changed the urban landscape of the city of Podujeva. This project started as an abandoned industrial space to become an attractive center for the community and visitors. One of the main characteristics of this project is the preservation of the architectural values of the existing constructions, while changing their functions to accommodate the new urban needs.*

Ky transformim ka sjellë një frymë të re në këtë zonë, duke e bërë atë të jetë një qendër e jetës bashkëkohore, ku njerëzit mund t'iu gëzohen blerjeve, të bëjnë zgjedhje të ndryshme kulinarie dhe të kalojnë kohën në hapësira të shumta lojërash. Kjo ndërthurje e funksioneve të ndryshme ofron shumëllojshmëri veprimtarish për komunitetin, duke sjellë një ndikim pozitiv në jetën e qytetit. Projekte të tilla demonstronë se si arkitektura dhe urbanizmi mund të transformojnë një hapësirë të pabanuar në një vend të qëndrueshëm me vlera të dukshme dhe të përdorshme për të gjithë.

*This transformation has brought a new spirit to this area making it a hub of contemporary life where people can enjoy shopping, have different culinary choices and spend time in gaming spaces. This combination of different functions offers diversity to the community, bringing a positive impact on the life of the city. Such projects demonstrate how architecture and urbanism can transform an uninhabited space into a sustainable place of visible and usable value for all.*



